



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr. 6

2001

Mars

PËRMBAJTJA

Ligj nr.8745
datë 22.2.2001

Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8080, datë
1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, ndryshuar me ligjin
nr.8168, datë 5.12.1996 157

L I G J
Nr.8745, datë 22.2.2001

PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8080, DATË 1.3.1996 “PËR LETRAT ME VLERË”, NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8168, DATË 5.12.1996

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
V E N D O S I :

Në ligjin nr.8080, datë 1.3.1996 “Për letrat me vlerë”, ndryshuar me ligjin nr.8168, datë 5.12.1996 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

KREU I

Neni 1

Në nenin 2 “Përkufizime” bëhen këto shtesat dhe ndryshime:

- Përkufizimi “njoftim” bëhet “publikim”.
- Përkufizimi “Këshilltar i licencuar investimesh” bëhet: ““Këshilltar i licencuar investimesh” mund të jetë një person fizik ose shoqëri tregtare e organizuar si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose si shoqëri anonime, i cili është lejuar nga autoriteti përkatës në vend të kryejë një veprimtari lidhur me këshillimin e të tjerëve për letrat me vlerë, përfshi marrëveshjet për blerjet, shitjet ose këmbimin e letrave me vlerë, por nuk përfshin:”
 - Përkufizimi i “Rregulla” bëhet:
““Rregulla” nënkupton rregullat që drejtojnë veprimtarinë e tregut të letrave me vlerë ose të anëtarëve të tij, me çfarëdo emri që paraqiten dhe kudo që të përfshihen, rregullat e listimit dhe normat e përfshira në statutin e shoqërisë së licensuar, për të vënë në veprim një treg të letrave me vlerë.”
 - Përkufizimi i “I listuar” shfuqizohet.
 - Përkufizimi “Letra me vlerë” bëhet:
““Letra me vlerë” nënkupton:
 - a) “aksione” si pjesë të kapitalit të një shoqërie tregtare;
 - b) “letra borxhi” si instrument që krijon ose konfirmon borxhin që është emetuar ose propozohet për t’u emetuar nga një shoqëri që përfshin, në veçanti, letra borxhi me maturim mbi një vit;
 - c) “letrat me vlerë të qeverisë dhe të borxhit publik” si hua, obligacione dhe instrumente të tjera që krijojnë ose vërtetojnë borxhin e emetuar nga Qeveria Shqiptare ose për të, ose nga një shoqëri publike, si dhe letrat me vlerë të emetuara nga Banka e Shqipërisë;
 - ç) “garanci” si e drejta për të nënshkruar aksionet ose letrat me vlerë të borxhit, të paraqitura nga garantues, ose të tjera të ngjashme (warranty);
 - d) “kontratë mundësie” si çdo kontratë që krijon mundësinë për të zotëruar ose për të vënë në përdorim çdo letër tjetër me vlerë (opcion);
 - dh) “kontratë e së ardhmes” si e drejtë sipas një kontrate për zotërimin ose vënien në përdorim të ndonjë letrë tjetër me vlerë, dorëzimi i së cilës do të bëhet në një datë të ardhshme dhe me një çmim mbi të cilin është rënë dakord në çastin e nënshkrimit të kontratës (futures);
 - e) të drejtat sipas një kontrate, e cila nuk siguron dorëzimin e letrave me vlerë, por qëllimi i së cilës është të sigurojë fitim ose të shmangë humbjet, duke iu referuar luhatjeve në:
 - (I) një indeks aksionesh ose faktorë të tjerë të ngjashëm, lidhur me letra të tjera me vlerë;
 - (II) çmimin e letrave të tjera me vlerë;
 - (III) përqindjen e interesit të ofruar për paratë në depozita;

ë) çdo instrument tjetër që gjykohet nga Komisioni për qëllimet e këtij ligji, si letër me vlerë, por nuk përfshin:

(I) kambialet;

(II) bonot e thesarit me një maturim fillestar më pak se tre muaj;

(III) premtim-pagesat;

(IV) certifikatat e depozitave të emetuara nga një bankë e licensuar nga Banka e Shqipërisë.”

- Përkufizimi “Nënshkrimi” bëhet:

““Nënshkrimi” nënkupton blerjen e letrave me vlerë të emetuara rishtazi, me qëllim rishitjen publike në emër të emetuesit ose garancinë për një emetues, që pjesa e pashitur e emetimit ose e shitjes publike të letrave me vlerë të emetuesit do të mbulohet nga nënshkruesi,”

- Në fund të nenit 2 shtohen përkufizimet “depozitar” dhe “prospekt”, përkatësisht me këtë përmbajtje:

““Depozitar” nënkupton një institucion financiar që ruan pasurinë e pjesëmarrësve të tregut të letrave me vlerë për llogari të investitorëve.

“Prospekt” nënkupton një dokument të shtypur, i hartuar nga emetuesi i letrave me vlerë dhe i miratuar nga Komisioni i cili përshkruan tiparet kryesore të veprimtarisë dhe që u shpërndahet investitorëve të ardhshëm si informacion i domosdoshëm për vendimmarrjen e tyre, sipas të gjitha rregullave të vendosura nga Komisioni.”

Neni 2

Në nenin 3 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

Pika 3 bëhet:

“3. Komisioni përbëhet nga shtatë anëtarë, të cilët emërohen nga Kuvendi për një periudhë pesëvjeçare. Dy komisionerë propozohen nga Presidenti i Republikës, dy nga Kuvendi, një nga Këshilli i Ministrave, një nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë dhe një nga Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë.

Vetëm për mandantin e parë, dy komisionerët e propozuar nga Kuvendi do ta kenë mandatin për katër vjet.

Vetëm për mandatin e parë komisionerët e propozuar nga Këshilli i Ministrave dhe Dhoma e Tregtisë do ta kenë mandatin për tre vjet.

Në rast se një komisioner largohet nga detyra për shkaqe të ndryshme, të parashikuara në këtë ligj, komisioneri që do ta zëvendësojë atë emërohet në të njëjtën mënyrë sipas përcaktimeve të këtij paragrafi dhe do të ushtrojë funksionet e tij vetëm për periudhën e mbetur të kohës. Komisionerët, të cilëve u ka mbaruar afati i emërimit të tyre, gëzojnë të drejtën e rizgjedhjes.”

Në pikën 4 rreshti i dytë fjalët “të paktën tre anëtarë të tij” zëvendësohen me fjalët “shumica e anëtarëve”.

Pas pikës 4 shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:

“Kandidatët për komisionerë duhet të plotësojnë kërkesat e mëposhtme:

a) Të kenë arsim të lartë universitar në fushën e ekonomisë ose të drejtësisë.

b) Të jetë shquar për etikë të lartë profesionale, morale dhe shoqërore.

c) Të mos jetë anëtar i organeve drejtuese të organizatave politike.

ç) Të mos bëjë pjesë në shoqëritë të cilat kontrollohen nga Komisioni.”

Pas pikës 5 shtohet pika 6 me këtë përmbajtje:

“Kryetari i Komisionit brenda një muaji nga konstatimi, njofton me shkrim Kuvendin për vendet e mbetura bosh të komisionerëve.”

Neni 3

Në nenin 4 pika 1, shkronjat (a), (b), (c) ndryshohen si më poshtë:

“(a) licencon, vëzhgon dhe mbikëqyr veprimtarinë e tregjeve të letrave me vlerë, si dhe të ofruesve të shërbimeve të pastrimit dhe të rregullimit të transaksioneve të letrave me vlerë, të depozitarëve të letrave me vlerë;

(b) licencon, mbikëqyr dhe vëzhgon veprimtaritë e tregtarëve, këshilltarëve të investimeve,

përfaqësuesve të tyre përkatës, drejtuesve të investimeve, fondeve të letrave me vlerë të licencuar;

(c) miraton statutin dhe rregullat e shoqërive të licencuara për të vepruar si treg i letrave me vlerë ose për të kryer shërbime të pastrimit dhe të rregullimit të transaksioneve të letrave me vlerë, depozitarëve e regjistruarve të letrave me vlerë, si dhe të fondeve të letrave me vlerë;”

Neni 4

Në nenin 5 bëhen këto ndryshime:
Në pikën 1 fjala “pesë” shfuqizohet.
Pika 4 shfuqizohet.

Neni 5

Në neni 6 pika 2 shkronja (ç), fjalët “paraqitur Presidentit” zëvendësohen me fjalët “paraqitur Kuvendit;”.

Neni 6

Në nenin 7 bëhen këto shtesa dhe ndryshime:
- Në pikën 1, në fund hiqet fjala “Komisioni” dhe zëvendësohet me “Kryetari”.
- Në pikën 5 shtohet një fjali me këtë përmbajtje: “Në rastet e një ndarjeje të barabartë të votave, Kryetari ka votë përcaktuese” dhe fjalia “Kryetari i Komisionit në çdo rast ka të drejtën e vetos” shfuqizohet.

Neni 7

Në nenin 12 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:
“c) nuk vlerësohet se veprohet në kundërshtim me paragrafin e parë të këtij neni, në rastet kur Komisioni kryen shkëmbim zyrtar të të dhënave mbi bazën e një marrëveshjeje të lidhur ndërmjet tij dhe institucioneve të tjera vendase ose të huaja mbikëqyrëse. Në këtë rast, Komisioni i nënshtrohet detyrimit të ruajtjes së konfidencialitetit për të dhëna të siguruar gjatë ekzekutimit të marrëveshjes;
ç) nuk vlerësohet se veprohet në kundërshtim me paragrafin e parë të këtij neni, në rastet e ofrimit zyrtar të të dhënave për organe të tjera vendase, në mbështetje të një detyrimi ligjor. Kur në këto të dhëna do të përdoren edhe të dhëna të siguruar si rezultat i ekzekutimit të marrëveshjeve të përmendura në paragrafin e tretë të këtij neni, Komisioni duhet të njoftojë paraprakisht institucionin nga i cili janë siguruar të dhënat.”

Neni 8

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:
- Në shkronjën “a”(iv), fjala “planeve” bëhet “prospekteve”.
- Në shkronjën “a”(vi), fjala “përvetësimin” zëvendësohet me “marrjen e paketës kontrolluese të aksioneve.”.

Neni 9

Neni 17 shfuqizohet.

Neni 10

Neni 18 shfuqizohet.

Neni 11

Neni 19 ndryshohet si vijon:

“Bordi mbikëqyrës i tregut të letrave me vlerë

Tregu i letrave me vlerë ka Bordin Mbikëqyrës të tij, i cili miratohet nga komisioni dhe funksionon në përputhje me dispozitat e ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”.

Neni 12

Neni 20 ndryshohet si vijon:

“ 1. Bordi Mbikëqyrës i tregut të letrave me vlerë, i krijuar sipas nenit 11 të këtij ligji, përbëhet nga të paktën 5 anëtarë.

2. Anëtarët e Bordit Mbikëqyrës duhet të jenë me reputacion të mirë, të zotërojnë arsimin e lartë përkatës dhe të kenë përvojë profesionale në fushën bankare dhe në veprimtarinë tregtare.

3. Bordi Mbikëqyrës për ushtrimin e veprimtarisë së tij harton rregulloren “Për funksionimin e Bordit Mbikëqyrës të tregut të letrave me vlerë”, e cila miratohet nga Komisioni.

4. Bordi vendos rregulla të tilla, që ai i vlerëson të nevojshme dhe të dëshirueshme për të pasur frytshmëri në rregullimin, veprimtarinë, drejtimin dhe kontrollin e tregut të letrave me vlerë, të cilat i bëhen të njohura paraprakisht Komisionit.

5. Kur Bordi Mbikëqyrës gjykon se është e nevojshme të bëhen ndryshime në rregulloret e tij, i paraqet Komisionit për miratim një projekt me ndryshimet e propozuara.

6. Komisioni, brenda 14 ditëve miraton ose kundërshton me shkrim pjesërisht ose plotësisht të gjitha ndryshimet e propozuara. Ndryshimet e propozuara dhe të pranuara sipas këtij paragrafi hyjnë në fuqi nga data e pranimi të tyre. Nëse ndryshimet e propozuara nuk kundërshtohen brenda 14 ditëve, miratimi do të konsiderohet i dhënë dhe efektet e tij juridike fillojnë në datën kur mbaron afati 14-ditor.”

Neni 13

Në nenin 21 pika 1 rreshti i dytë, fjalët “Banka e Shqipërisë” zëvendësohen me “Komisioni”.

Neni 14

Neni 22 ndryshohet si vijon:

“Autoriteti i Komisionit për të kërkuar amendamente të rregullave

Kur Komisioni e gjykon të nevojshme për mbrojtjen e investitorëve, mund t'i kërkojë me shkrim Bordit Mbikëqyrës të bëjë ose të ndryshojë një ose disa rregulla. Komisioni duhet të specifikojë amendamentet dhe datën kur do të hyjnë në fuqi ndryshimet e tyre. Bordi Mbikëqyrës vepron në përputhje me këtë kërkesë sa më shpejt të jetë e mundur, pas marrjes së njoftimit nga Komisioni.”

Neni 15

Neni 23 ndryshohet si vijon:

“Bordi i ofron asistencë Komisionit kur ai e kërkon një gjë të tillë, për qëllim të kryerjes së funksioneve të tij, duke i dhënë njoftim lidhur me tregtimin e letrave me vlerë ose të dhënë tjetër të veçantë që Komisioni mund të kërkojë për administrimin e duhur të këtij ligji.”

Neni 16

Neni 24 ndryshohet si vijon:

“Krijimi i tregut të letrave me vlerë

Tregjet e letrave me vlerë licensohen nga Komisioni në përputhje me dispozitat e parashikuara në këtë ligj.”

Neni 17

Në nenin 28 pika 2 ndryshohet si vijon:

“Pas marrjes së njoftimit me shkrim, Komisioni, pavarësisht nga propozimi i bërë nga bordi, ka të drejtë të marrë çdo vendim në lidhje me masat që duhen marrë për të licensuarin.”

Neni 18

Shkronja (d) e pikës 2 e nenit 29 ndryshohet si vijon:

“(d) ofrimi i shërbimeve depozituese i letrave me vlerë, si dhe ofrimi i shërbimeve për regjistrimin e letrave me vlerë; dhe”

Neni 19

Në shkronjat (a) dhe (b) të pikës 7 të nenit 31, numri “25” zëvendësohet me numrin “10”.

Neni 20

Në pikën 1 të nenit 36, hiqet fjalia:

“Komisioni do të njoftojë Bankën e Shqipërisë për çdo licencë të miratuar.”

Neni 21

Në pikën 2 të nenit 37, hiqen fjalët “dhe Bankës së Shqipërisë”.

Neni 22

Në nenin 38 bëhen këto ndryshime:

-Titulli i nenit bëhet: “Ofertat e aksioneve, të letrave të borxhit dhe garancive”.

- Në pikën 1, fjalët “premtim-pagesat” zëvendësohen me “letrat e borxhit”.

Në pikën 3, fjalët: “më shumë se 100 personave” zëvendësohen me: “më shumë se 50 personave”.

- Pika 4 ndryshohet si vijon:

“Publikimi, i ndryshëm nga prospekti, i cili shpall një ofertë publike të letrave me vlerë, për të cilën sipas këtij kreu kërkohet një prospekt, nuk do t’i paraqitet publikut në Republikën e Shqipërisë, në qoftë se publikimi nuk përcakton se është publikuar më parë një prospekt dhe nuk jep një adresë në Republikën e Shqipërisë nga ku mund të sigurohet ky publikim.”

Neni 23

Neni 39 ndryshohet si vijon:

“Publikimi dhe regjistrimi i prospektit

1. Kur në Republikën e Shqipërisë bëhet një ofertë publike letrash me vlerë, ofruesi do të publikojë një prospekt, i cili do të jetë në dispozicion të publikut falas dhe në një adresë të caktuar në Republikën e Shqipërisë, gjatë gjithë periudhës së kohës që oferta e letrave me vlerë qëndron e hapur.

2. Ofruesi duhet, jo më pak se 21 ditë përpara publikimit të prospektit, të dorëzojë një kopje të

tij për regjistrim pranë Komisionit.

3. Nuk mund të publikojë një prospekt një person i paregjistruar nga Komisioni.

4. Nëse një person që bën një ofertë publike ka publikuar një prospekt brenda 12 muajve në vijim nga data kur oferta është bërë për herë të parë, mund të publikojë një prospekt vetëm për diferencat që rezultojnë që nga publikimi i prospektit të mëparshëm dhe që ka mundësi të ndikojë në vlerën e letrave me vlerë, me kusht që prospekti i ri të shoqërohet edhe me një kopje të atij të mëparshmit.”

Neni 24

Në nenet 40 dhe 41 fjala “plan” bëhet “prospekt”.

Neni 25

Në nenin 42 bëhen këto ndryshime:

Në pikën 1 rreshti i dytë hiqen fjalët “dhe Bankën e Shqipërisë”.

Në pikën 2 rreshti i dytë fjalët: “më shumë se 100” zëvendësohen me “më shumë se 50”.

Neni 26

Titulli i Kreut VII bëhet: “ETIKA E VEPRIMTARISË SË INVESTIMIT NË LETRAT ME VLERË”.

Neni 27

Në nenin 43 bëhen këto ndryshime:

- Fjalët e para të nenit 43 “Në drejtimin e” zëvendësohen me fjalën “Gjatë”.

- Në paragrafin me shkronjën (h) hiqen fjalët “dhe Bankën e Shqipërisë”.

Neni 28

Neni 44 ndryshohet si vijon:

“Rregullat e Etikës

1. Këshilli i Ministrave, pas këshillimeve me Komisionin, mund të përcaktojë rregulla për etikën e veprimtarisë së investimit në letrat me vlerë nga subjektet e licencuara.

2. Kur ndonjë kontratë për shitjen apo blerjen e letrave me vlerë është në kundërshtim dhe shkel rregullat e etikës, të përcaktuara sipas këtij neni, shkelja është objekt padie civile nga personi i cili ka pësuar humbje prej një shkeljeje të tillë.”

Neni 29

Neni 48 ndryshohet si vijon:

“Publikimet

Këshilli i Ministrave, pas këshillimeve me Komisionin, mund të përcaktojë rregulla që kanë të bëjnë me formën dhe përmbajtjen e publikimeve për veprimtarinë e investimit në letrat me vlerë dhe mund të vendosë kufizime mbi personat që bëjnë këto publikime.”

Neni 30

Pika 1 e nenit 49 ndryshohet si vijon:

“Tregtimi, këshillimi ose caktimi i një personi tjetër për të tregtuar letrat me vlerë të një shoqërie tregtare, duke shfrytëzuar për qëllime përfitimi të dhëna të siguruara nga burime të brendshme që ndikojnë në çmimin e letrave me vlerë, përbëjnë tregtim me të dhëna të brendshme dhe dënohen me gjobë ose me heqje lirie deri në 3 vjet.”

Neni 31

Titulli i Kreut IX bëhet: “MARRJA E PAKETËS KONTROLLUESE”.

Neni 32

Neni 55 ndryshohet si vijon:

“Marrja e paketës kontrolluese

Në këtë kre, “oferta për marrje të paketës kontrolluese” nënkupton një ofertë për të marrë paketën kontrolluese nga/ose në emër të një shoqërie tregtare (“ofruesi”) ose

1. të gjitha aksionet e një shoqërie tregtare tjetër (shoqëria tregtare e ofruar), të ndryshme nga aksionet, të cilët në datën e ofertës zotërohen nga ofruesi;

2. ato aksione në shoqërinë tregtare të ofruar që rezultojnë në marrjen e kontrollit efektiv të shoqërisë tregtare nga ana e ofruesit.

Në kuptim të pikës 1 të këtij neni, “marrja e kontrollit efektiv” nënkupton marrje të paketës kontrolluese të aksioneve në një shoqëri tregtare ofruese e cila, bashkë me aksionet, nëse ka, që zotëron aktualisht ofruesi ose një shoqëri tregtare tjetër që parashikohet nga neni 56 i këtij ligji, si e lidhur me ofruesin, ka të drejtën të ushtrojë ose të kontrollojë ushtrimin e jo më pak se 50 për qind të të drejtave përkatëse të aksioneve me të drejtë vote në shoqërinë tregtare ofruese.”

Neni 33

Në nenin 57, në pikën 1 dhe 2, fjalët “të përvetësimit” zëvendësohen me fjalët “për marrje të paketës kontrolluese”.

Neni 34

Në nenin 60, pika 1, shkronja (b)(iii), fjala “përvetësimin” zëvendësohet me “marrje të paketës kontrolluese”.

Neni 35

Në shkronjën (a) të nenit 63, fjalët “nga 5 mijë deri në 200 mijë lekë” zëvendësohen me “nga 30 mijë deri në 1 milionë lekë”.

Në shkronjën (b) të nenit 63, fjalët “nga 10 mijë deri në 2 milionë lekë” zëvendësohen me fjalët “nga 50 mijë deri në 5 milionë lekë.”

Neni 36

Dispozita Kalimtare

Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, që brenda gjashtë muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të marrin masat e nevojshme për transformimin e Bursës së Tiranës në shoqëri anonime.

Deri në transformimin e Bursës së Tiranës në shoqëri anonime, sipas këtij neni, ajo do të qëndrojë në varësi të Bankës së Shqipërisë.

Neni 37

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.2918, datë 9.3.2001 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Rexhep Meidani**

Doli nga shtypi më 14.3.2001